

Projekti është i financuar nga “Fondacioni Shoqëri e hapur – Maqedoni”

Observatori për reforma mediatike

Raporti i parë periodik nga vëzhgimi i përmbushjes së reformave prioritare nga fusha e mediave

Periudha e raportimit: 1.7.2017 – 01.11.2017

Ky raport është rezultat i procesit të vëzhgimit të realizimit të reformave prioritare (RUP) nga fusha e mediave në kuadër të projektit “Observatori për reforma mediatike”, të cilin e realizojnë Fondacioni “Metamorfozis”, “Agora” dhe PINA. Projekti është i mbështetur nga “Fondacioni Shoqëri e hapur në Maqedoni (FSHHM).

Të gjitha materialet që janë produkt i këtij projekti dhe i vëzhgimit të realizuar gjenden në ueb-faqen e veçantë të dizajnuar për nevojat e projektit. Ueb-faqja është: mediaobservatorium.mk

nëntor 2017

Informatat dhe qëndrimet e publikuara nuk i paraqesin qëndrimet zyrtare të Fondacionit Shoqëri e hapur - Maqedoni.

Projektin “Observatori për reforma mediatike”, e realizon Fondacioni për internet dhe shoqëri “Metamorfozis”, në partneritet me SHQ “Agora” – Qendra për promovimin e vlerave qytetare dhe PINA – Platforma për gazetari hulumtuese dhe analiza.

Përmbajtja

Përmbledhje e shkurtër	3
Hyrje.....	4
Qëllimet dhe metodologjia e vëzhgimit.....	6
Qëllimi dhe metodat e raportit.....	6
Hulumtimi	7
Raportet e Grupit të ekspertëve të pavarur me përvojë, të udhëhequr nga R. Pribe.....	8
Konstatimet kyçe nga vëzhgimi	8
1. Transmetuesi publik i radiodifuzionit	9
2. Reklamimi qeveritar	11
3. Qasja te informatat	12
4. Shpifja	14
Literatura e shfrytëzuar	15

Shkurtesat

RM – Republika e Maqedonisë;

BE – Bashkimi Evropian;

KE – Komisioni Evropian;

RUP – Reformat urgjente prioritare; reformat prioritare;

ASHAAM – Agjencia për shërbime audio dhe audio-vizuale mediatike;

Fjalët kyçe

Media-vëzhguese, media-vëzhgim, reformat prioritare (urgjente), Pribe, mediat, transmetuesi publik i radiodifuzionit, reklamimi qeveritar, qasja te informatat, shpifja.

Vërejtje

Teksti është përgatitur në kuadër të projektit “Observatori për reforma mediatike”, të cilin e realizojnë Fondacioni për internet dhe shoqëri “Metamorfozis”, “Agora” – Qendra për promovimin e vlerave qytetare dhe Platforma për gazetari hulumtuese dhe analiza (PINA), me mbështetje financiare të “Fondacionit Shoqëri e hapur – Maqedoni”.

Përmbajtja e tekstit është përgjegjësi e vetme e autorëve dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se i pasqyron pikëpamjet e “Fondacionit Shoqëri e hapur – Maqedoni”.

Përmbledhje e shkurtër

Ky raport periodik i prezanton rezultatet nga vëzhgimi i përbushjes së Reformave urgjente prioritare (RUP) që kanë të bëjnë me lirinë e të shprehurit, në periudhën prej korrikut deri në tetor të vitit 2017, në kuadër të projektit “Observatori për reforma mediatike”, të cilin e realizojnë Fondacioni për internet dhe shoqëri “Metamorfozis”, “Agora” – Qendra për promovimin e vlerave qytetare dhe Platforma për gazetari hulumtuese dhe analiza (PINA), me mbështetje financiare të “Fondacionit Shoqëri e hapur – Maqedoni”.

Si rezultat i vëzhgimit të katër shtyllave të RUP, u përcaktuan këto konstatime kyçe:

- **Transmetuesi publik i radiodifuzionit** – ndryshimet e filluara legjislative me të cilat përcaktohet stabiliteti financiar i transmetuesit publik të radiodifuzionit janë vetëm një pjesë e reformave të nevojshme me qëllim të profesionalizimit, zhvillimit teknik-teknologjik, programor dhe kadrovik të RTM-së. Me këtë rast, vlerësohet se masa që është miratuar tani do të çojë në kufizim drastik të buxhetit të tij. E filluar, mirëpo e porealizuar
- **Reklamimi i qeveritar** – Qeveria publikoi se do t'i heqë reklamat e saj në media dhe se komunikimin e mëtutjeshëm me publikun do ta bëjë nëpërmjet transmetuesit publik dhe mediave sociale. Nuk u dhanë detaje për ndonjë veçori në lidhje me këtë problematikë, p.sh. a do të paguhen reklamat në RTM, produksioni i spoteve reklamuese dhe fushatat e paguara në rrjetet sociale. Pjesërisht e realizuar
- **Qasja te informatat** – Qeveria filli proces të “trajtimit të pengesave kryesore me të cilat përballen gazetarët gjatë marrjes së informatave publike” duke i vënë në dispozicion publik një sërë dokumentesh të institucioneve shtetërore, të klasifikuara më parë si “sekrete”. Qeveria siguroi qasje falas për gazetarët në të dhënat e dy institucioneve që kanë baza të të dhënave me interes publik. Komuniteti i gazetarëve kërkon ndryshime dhe plotësim të Ligjit për qasje të lirë deri te informatat me karakter publik me qëllim të shkurtimit të afateve për të dhënë përgjigje. Pjesërisht e realizuar
- **Shpifja dhe ofendimi** – nuk është ndryshuar legjislacioni, gjegjësisht Ligji për përgjegjësi qytetare për shpifje dhe ofendim dhe rregullat procedurale me qëllim që të harmonizohen me praktikën e Gjykatës evropiane për të drejtat e njeriut, sipas RUP dhe rekomandimeve të Pribes. Qeveria nuk ka publikuar masa për mbështetjen e mekanizmave për vetërregullim. Fare e porealizuar

Obesrvatori për reforma mediatike do të vazhdojë me ndjekjen e realizimit të Reformave urgjente prioritare edhe në periudhën e ardhshme, duke i prezantuar rezultatet në formë të raporteve periodike, lajmeve dhe storjeve hulumtuese, me qëllim të përfshirjes sa më të madhe të qytetarëve të Republikës së Maqedonisë në proceset demokratike.

Hyrje

Republika e Maqedonisë në disa vitet e fundit u përball me një krizë serioze politike, e cila gradualisht thellohej dhe paraqiste sfidë të madhe në aspekt të zhvillimit ekonomik, social dhe politik të vendit, si dhe nga aspekti i realizimit të prioriteteve strategjike dhe të ndjekjes së agjendës progresive euroatlantike të vendit.

Kriza politike e arriti kulmin e saj në vitin 2015, kur ajo u shoqërua me disa momente kyçe, siç ishte publikimi i bisedave të përgjuara të funksionarëve të lartë të pushtetit dhe të liderëve partiakë, ngritja e padive penale për publikimin e paligjshëm të këtyre materialeve, si dhe organizimi i një numri të madh të protestave në shenjë revolte për shkak të incizimeve të publikuara dhe përmbytjeve të tyre. Natyra dhe përmasat e kësaj krize politike kërkuan angazhim serioz dhe të ekspertizës edhe të faktorit ndërkombëtar për zgjidhjen e saj, i cili i zhvilloi negociatat për pajtim dhe për zgjidhjen e situatës së krizës së bashku me udhëheqësitë e partive më të mëdha politike në vend.

Partitë politike me ndërmjetësimin e bashkësisë ndërkombëtare, të udhëhequr nga BE-ja dhe SHBA-të, arritën marrëveshje kompromise në qershor të vitit 2015 – Marrëveshjen e Përzhinës¹, me të cilën partitë politike që e nënshkruan atë, u morën vesh për zgjidhjen përfundimtare të krizës, si dhe për zbatimin e zgjidhjeve sistimore dhe të reformave për përbushjen e rekomandimeve të dhëna nga Komisioni Evropian, në kuadër të kësaj marrëveshjeje, mirëpo edhe të proceseve paraprake për përbushjen e kushteve të vendit për hapjen e negociatave për anëtarësim në Bashkimin Evropian dhe në NATO.

Menjëherë pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Përzhinës, Komisioni Evropian përgatiti edhe një dokument të veçantë me reformat prioritare (Urgent Reform Priorities – Reformat urgjente prioritare – RUP) për Maqedoninë², të cilat vendi duhet t'i realizojë në fushat e sundimit të së drejtës, depolitizimit të administratës publike, lirisë së të shprehurit dhe reformave zgjedhore.

Reformat urgjente prioritare (RUP) janë një dokument që ndërlidhet me Raportin e ekipit të ekspertëve të udhëhequr nga Rajnhard Pribe³. Ai është i ndarë në pesë kapituj: Sundimi i të drejtës dhe gjyqësia; Depolitizimi i administratës publike; Reformat zgjedhore; Zbatimi i rekomandimeve të Komisionit anketues për ngjarjet e 24 dhjetorit; dhe Mediat: liria e të shprehurit.

Në përputhje me negociatat për arritjen e Marrëveshjes së Përzhinës, mirëpo në mënyrë eksplicite edhe me reformat prioritare, reformat në fushën e mediave dhe lirisë së të shprehurit janë me rëndësi thelbësore për zhvillimin e pushtetit transparent, demokratik dhe të lirë në vend. Konkretisht, reformat në fushën “Mediat: liria e të shprehurit” kanë për qëllim arritjen e përparimit dhe zgjidhjen e problemeve në katër sfera: transmetuesi publik i radiodifuzionit, reklamimi qeveritar, qasja te informatat dhe shpifja.

¹ Przino Agreement – Agreement in Skopje to overcome political crisis, 2 June 2015, Skopje https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/news_corner/news/news-files/20150619_agreement.pdf

² Reformat urgjente prioritare – përkthim në gjuhën maqedonase: https://eeas.europa.eu/sites/eeas/files/urgent_reform_priorities_mk.pdf. Në origjinal në anglisht: Urgent Reform Priorities for Macedonia, Komisioni Evropian, DGJ Politika evropiane për fqinjësi dhe negociatat për zgjerim, qershor 2015 https://eeas.europa.eu/sites/eeas/files/urgent_reform_priorities_en.pdf

³ Recommendations of the Senior Experts' Group on systemic Rule of Law issues relating to the communications interception revealed in Spring 2015, https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/news_corner/news/news-files/20150619_recommendations_of_the_senior_experts_group.pdf

Rëndësinë e reformave të mediave dhe lirisë së të shprehurit e pranon edhe pushteti aktual, i cili parasheh masa dhe aktivitete në këtë sferë në Programin për punë të qeverisë 2017-2020⁴, si dhe në kuadër të planit “3-6-9”⁵. Në përputhje me këto dokumente, qeveria përkushtohet që në pjesën e mediave të ndërtojë partneritet me shoqatat dhe me sektorin qytetar, që ta lirojë hapësirën mediatike nga çfarëdo lloj ndikimi institucional ose personal, duke e përfshirë edhe varësinë financiare. Prandaj, qeveria e ndërpreu reklamimin komercial në media, do ta përforcojë dhe plotësisht do ta profesionalizojë transmetuesin publik të radiodifuzionit dhe do t’i hapë për publikun të gjitha informatat që janë me karakter publik dhe që janë me interes publik.

⁴ Programi për punë i Qeverisë së RM-së, http://vlada.mk/sites/default/files/programa/2017-2020/Programa_Vlada_RM_Juni_Dekemvri_2017.pdf

⁵ Qeveria e RM-së, plani “3-6-9”, <http://vlada.mk/plan-3-6-9>

Qëllimet dhe metodologjia e vëzhgimit

Qëllimi dhe metodat e raportit

Ky raport është dedikuar, para së gjithash, për informimin e publikut të gjerë ose qytetarëve për procesin e realizimit të RUP në fushën e mediave, në mënyrë të kuptueshme, të përshtatshme për opinionin e gjerë dhe publikun joekspert. Poashtu, raporti do t'i informojë edhe palët e tjera të interesuara, siç janë mediat, institucionet dhe sektori qytetar.

Raporti ka për qëllim të sigurojë informata adekuate për përparimin e realizimit të reformave të parapara në fushën e mediave.

Ky raport është përgatitur në përputhje me metodologjinë për vëzhgim, që përfshin një sërë aktivitete dhe masash për mbledhjen e të dhënave dhe për ndjekjen e proceseve të reformave. Metodologjia bazohet në zbatimin e një sërë aktivitete hulumtuese, duke filluar nga analiza e kornizës aktuale juridike dhe e gjendjeve në media dhe me lirinë e të shprehurit, pastaj zbatimin e vëzhgimit ditor dhe periodik, si dhe analizave hulumtuese, organizimit të grupeve të fokusit me persona që kanë informata kyçe etj.

Hulumtimi në zyrë do të fokusohet në mbledhjen e të dhënave dhe në analizën e të gjitha dokumenteve relevante që kanë të bëjnë me realizimin e RUP në fushën e mediave, siç janë raportet vjetore të BE-së për Maqedoninë, raportet e Pribes, si dhe dokumentet dhe raportet e institucioneve nacionale ose organizatave që kanë të bëjnë me reformat prioritare të mediave. Këto të dhëna do të sigurohen nëpërmjet kanaleve të ndryshme të informacioneve, duke i përfshirë edhe rrjetet e bashkëpunëtorëve në sektorin qytetar dhe atë mediatik, si dhe nga vetë institucionet nëpërmjet Ligjit për qasje të lirë deri te informatat me karakter publik.

Për ndjekje më të mirë dhe të rregullt të gjendjeve me realizimin e reformave mediatike, në kuadër të projektit do të realizohen aktivitete të **vëzhgimit periodik dhe ditor** të ueb-faqeve relevante për përmbajtjet që kanë të bëjnë me reformat mediatike.

Gjatë projekti do të realizohen edhe dy **grupe të fokusit** që të fitohen informata nga personat dhe ekspertët që kanë informata kyçe nga fushat që kanë të bëjnë me realizimin e RUP-it nga sektori qytetar, akademik, privat dhe ai qytetar. Njohuritë nga grupi i parë i fokusit që u mbajt më 9 tetor të vitit 2017 janë përfshirë në rezultatet e vëzhgimit dhe do të shërbejnë si udhëzime për aktivitetet e mëtejshme për vëzhgim dhe për hulumtime gazetareske.

Pastaj, për prezantimin e konstatimeve të vëzhgimit, si dhe për të nxitur dialog më të gjerë ndërmjet krijuesve të politikave dhe faktorëve të tjerë ose publikut, do të realizohen **dy debate publike**, të cilat kanë për qëllim ta kycin shoqërinë qytetare në këto procese.

Rezultatet e vëzhgimit do të publikohen në formë të **analizave tremujore dhe analizës përfundimtare**. Në nivel të projektit, këto informata do të plotësohen me **artikuj hulumtues**, nëpërmjet të cilëve qytetarëve do t'u ofrohen njohuri plotësuese për kontekstin, gjendjet paraprake që kanë çuar në gjendjet aktuale, si dhe obligimet që janë ndërmarrë nga institucionet e RM-së për realizimin e reformave prioritare.

Vëzhgimi realizohet nga ana e një ekipi multi-diciplinar të projektit, të përbërë nga anëtarët e tre organizatave partnere me ekspertizë komplementare (gazetarë, ekspertë mediatikë dhe juristë).

Aktivitetet hulumtuese do të konstatojnë katër nivele të realizimit të obligimeve që dalin nga RUP në fushën "Mediat: liria e të shprehurit". Këto katër nivele janë:

1. Fare e porealizuar – asgjë konkrete nuk është filluar.
2. E filluar, mirëpo e porealizuar – kanë filluar aktivitetet për ndryshimin e legjislacionit.

3. Pjesërisht e realizuar – janë bërë ndryshimet ligjore, mirëpo nuk ka filluar implementimi.
4. Plotësisht e realizuar – reformat janë realizuar në tërësi.

Gjatë paraqitjes vizuale, për komunikim më të lehtë me publikun e gjerë, do të përdoren kode me ngjyrë për secilin nga këto nivele të përcaktuara të realizimit (e kuqe, portokalle, e verdhë dhe e gjelbër).

1. Fare e porealizuar – asgjë konkrete nuk është filluar.	
2. E filluar, mirëpo e porealizuar – kanë filluar aktivitetet për ndryshimin e legjislacionit.	
3. Pjesërisht e realizuar – janë bërë ndryshimet ligjore, mirëpo nuk ka filluar implementimi.	
4. Plotësisht e realizuar – reformat janë realizuar në tërësi.	

Fotografia 1: Nivelet e realizimit dhe kodet e ngjyrave.

Aktivitetet për vëzhgimin e gjendjeve i realizon ekipi multi-diciplinar i projektit, i përbërë nga anëtarët e tre organizatave partnere me ekspertizë komplementare (gazetarë, ekspertë mediatikë dhe juristë).

Hulumtimi

Reformat prioritare nga fusha “Mediat: liria e të shprehurit” parashohin ndërmarrje të një sërë masash dhe aktiviteteve konkrete që duhet t’i ndërmarrin institucionet relevante të vendit me qëllim të arritjes së përparimit drejt demokratizimit dhe qeverisjes së mirë. Këto masa dhe aktivitete janë ndarë në katër shtylla për realizimin e reformave të parapara në fushën e mediave: Transmetuesi publik i radiodifuzionit, reklamimi qeveritar, qasja te informatat dhe shpifja. Në kuadër të secilës nga shtyllat janë paraparë veprime plotësuese që kontribuojnë për realizimin e qëllimit të shtyllës kryesore. Reformat që duhet të realizohen janë:

Transmetuesi publik i radiodifuzionit: Të sigurohen dëshmi të dukshme për reforma në transmetuesin publik të radiodifuzionit në aspekt të politikës së punës, organizimit, edukimit dhe redaksisë dhe mungesës së pavarësisë politike, mungesës së raportimit të balancuar, si dhe sigurimit të përmbajtjeve informative, me cilësi të lartë.

Reklamimi qeveritar: Të vendosen rregulla të rrepta për reklamim qeveritar të bazuar në kritere transparente, objektive dhe jodiskriminuese; të sigurohet transparencë e plotë e reklamimit qeveritar dhe të zhvillohet mekanizëm për publikime falas në transmetuesin publik, të cilat me të vërtetë janë me interes publik.

Qasja te informatat: Të trajtohen pengesat kryesore me të cilat ballafaqohen gazetarët gjatë marrjes së informatave publike.

Shpifja: Zvogëlimi i rasteve të shpifjeve duke e ndryshuar legjislacionin, duke i ndryshuar rregullat procedurale, duke e mbështetur dhe duke e promovuar përdorimin më të madh të vetërregullimit si alternativë për procedurën gjyqësore, si dhe garantimi dhe zbatimi, në nivel politik, i praktikimit adekuat të vetëkufizimit nga politikanët dhe funksionarët publikë që të mos iniciohet procedurë për shpifje, në përputhje me parimet e GJEDNJ-së.

Raportet e Grupit të ekspertëve të pavarur me përvojë, të udhëhequr nga R. Pribe

Ndjekja e implementimit të reformave prioritare bëhet rregullisht nga ana e Komisionit Evropian, gjegjësisht nga grupi i ekspertëve të lartë të pavarur që e formoi KE-ja për ta analizuar situatën dhe për të ofruar rekomandime për çështjet sistematike sa i përket sundimit të të drejtës, e të cilat janë të lidhura me ndjekjen e komunikimeve, që u zbulua në pranverë të vitit 2015.

Raporti i parë i grupit të ekspertëve, i cili u publikua në qershor të vitit 2015, i konstatoi mangësitë dhe problemet kyçe në sferën mediatike në vend dhe dha rekomandime për zgjidhjen e tyre menjëherë pas realizimit të reformave në pushtet dhe në institucione. Problemet kyçe që u përmendën kanë të bëjnë me ndikimin politik dhe financiar mbi transmetuesin publik të radiodifuzionit dhe mbi mediat e tjera, reklamimin qeveritar, qasjen të informatat me karakter publik dhe shpifjen.

Në shtator të vitit 2017, Grupi i ekspertëve të pavarur me përvojë e përgatiti raportin e parë⁶, me të cilin u bë vlerësim i përparimit në trajtimin e konstatimeve dhe të rekomandimeve të tyre paraprake, që u dhanë në raportin e parë në vitin 2015. Me këtë raport, në masë të madhe u konstatuan problemet dhe sfidat paraprake në sferën mediatike dhe lirinë e të shprehurit dhe është konstatuar shkallë e ulët ose e kufizuar e realizimit të reformave të parapara. Duke e pasur parasysh këtë, mbeten të vlejshme edhe më tutje rekomandimet e dhëna në raportin e parë në vitin 2015, e në mënyrë plotësuëse janë dhënë edhe rekomandime të reja. Rekomandimet e reja nga raporti i vitit 2017 kanë të bëjnë me ndërtimin e strategjisë qeveritare për realizimin e reformave në media, të bazuar në analizë adekuate dhe në planifikim në mënyrë transparente dhe pjesëmarrëse me përfaqësuesit e të gjithë faktorëve relevantë nga sektori publik dhe ai privat. Pastaj, rekomandimet kanë të bëjnë edhe me përmirësimin e kapaciteteve të mediave dhe me përforcimin e rolit të tyre për shtet llogaridhënës, gazetari hulumtuese etj. Rekomandimet e tjera kanë të bëjnë me përmirësimin e funksionimit të “Radiotelevizionit të Maqedonisë” (RTM) në aspekt të pavarësisë së tij dhe udhëheqjes dhe punës efektive, si dhe transparencës dhe llogaridhënies ndaj të gjithë faktorëve. Poashtu, duhet të sqarohet situata me financimin e Agjencisë për shërbime audio dhe audio-vizuale mediatike që të sigurohet pavarësia e saj dhe pavarësia e Këshillit të saj.

Implementimi i RUP, poashtu, është vëzhguar edhe nga organizatat dhe institucionet e tjera ndërkombëtare, si dhe nga sektori qytetar dhe nga mediat në Maqedoni. Konstatimet dhe përfundimet e tyre, në përgjithësi, janë në vijë me gjendjet e konstatuara dhe problemet edhe sfidat e identifikuar në raportet e Pribes.

Nga ana tjetër, Qeveria e Republikës së Maqedonisë dhe institucionet e tjera informojnë për aktivitetet e tyre për realizimin e reformave prioritare. Në periudhën e deritanishme nga analiza e informatave dhe e dokumenteve të tyre vërehet se një pjesë e reformave të parapara janë në realizim e sipër.

Gjatë përgatitjes së raportit nga vëzhgimi, përveç dy raporteve të Rajnhard Pribes, u shfrytëzuan edhe produktet gazetareske të agjencisë së lajmeve “Meta”, storjet e “PINA”, raportet nga vëzhgimi zgjedhor i ASHAAM-it dhe konstatimet e paraqitura në mbledhjen e grupit të fokusit të përbërë nga profesionistët mediatikë për nevojat e këtij projekti.

Konstatimet kyçe nga vëzhgimi

⁶ The former Yugoslav Republic of Macedonia: Assessment and recommendations of the Senior Experts' Group on systemic Rule of Law issues 2017, https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/2017.09.14_seg_report_on_systemic_rol_issues_for_publication.pdf

E filluar, mirëpo
e përealizuar

1. Transmetuesi publik i radiodifuzionit

Në kuadër të shtyllës së parë të RUP në fushën e mediave, janë dhënë rekomandime "që të sigurohen dëshmi të dukshme për reformat aktuale në transmetuesin publik të radiodifuzionit në aspekt të politikës së punës, organizimit, edukimit dhe redaksisë, si dhe mungesës së pavarësisë politike, mungesës së raportimit të balancuar, si dhe sigurimit të përmbajtjeve informative, me cilësi të lartë."

LSDM-ja në pushtet në kuadër të fushatës së saj parazgjedhore publikoi se do ta heqë taksën për radiodifuzion që e paguanin qytetarët, e cila ishte dedikuar për financimin e transmetuesit publik të radiodifuzionit.

1.1. Plani për heqjen e taksës për radiodifuzion u realizua kur qeveria e dorëzoi këtë propozim-masë në Kuvend. Ajo u votua në mbledhjen plenare të Kuvendit të mbajtur më 19 shtator⁷, e me propozim të një grupi deputetësh. Me këtë propozim, që nga tetori i vitit 2017, qytetarët më nuk duhet ta paguajnë taksën për radiodifuzion, ndërsa qeveria nga buxheti do të ndajë mjete për punë të papenguar të transmetuesit publik të radiodifuzionit. Ky vendim shkaktoi reagime të ndryshme në publik. Sipas anketave të qytetarëve të bëra nga stacionet televizive, për ta kjo masë paraqet lehtësim për buxhetin e tyre, i cili edhe ashtu është modest. Nga ana tjetër, një pjesë e shoqatave profesionale konsiderojnë se buxheti që e ka planifikuar qeveria si kompensim për taksën e hequr të radiodifuzionit nuk do të mjaftojë për funksionin e saj të papenguar. Analizat e buxhetit të RM-së, si dhe analizat e punës financiare të RTM-së, e flasin të kundërtën e asaj që e thotë [propozuesi](#)⁸ se me mënyrën e këtillë të financimit, RTM-ja do të ketë mjete të sigurta për punë të papenguar. [Analiza buxhetore](#)⁹ për vitin 2017 tregon se me projektimet e këtilla, RTM-ja do të ketë buxhet më të vogël, edhe atë ndërmjet 5 dhe 7 milionë euro. Nga ana tjetër, më 3 nëntor të vitit 2017, [RTM-ja njoftoi](#)¹⁰ se problemi me borxhet do të ishte zgjidhur sikur UJP-ja të mos i kishte borxh prej 34 milionë eurosh RTM-së.

Sipas Ligjit aktual për shërbime audio dhe audiovizuale mediatike, organi kyç rregullator dhe rregullimi i transmetuesit publik të radiodifuzionit nuk janë në përputhje me rekomandimet e Këshillit të Evropës, me të cilat parashihet që ato të jenë politikisht të pavarura dhe të ketë sistem të qëndrueshëm të financimit të pavarur të tyre.

Në përputhje me rekomandimet e lartpërmendura nga Raporti i Pribes, gjegjësisht dy raportet dhe [planin "3-6-9"](#)¹¹, qeveria filloi proces për ndryshimin dhe për plotësimin e Ligjit për shërbime audio dhe audiovizuale mediatike. Sipas [planit](#) të ministrisë përkatëse, forma finale e

⁷ Propozim-ligji për ndryshimin e Ligjit për shërbime audio dhe audiovizuale mediatike, me procedurë të shkurtuar <http://www.sobranie.mk/materialdetails.nspx?materialId=d9c2f24d-4522-4e39-aab6-0c9bf85ebbd9>

⁸ T. Tuntev (19.09.2017.) Heqja e taksës për radiodifuzion do të sigurojë financim më efikas të transmetuesit publik. Ueb-faqja e LSDM-së. <http://www.sdsd.org.mk/News.aspx?idNews=9641&lng=1>

⁹ T. Bllazhevski. (20.09.2017.) Kontraspin: RTM-ja do të ketë buxhet më të vogël për 5 deri në 7 milionë euro! Vërtetmatësi. <http://vertetmates.mk/kunderspin-rtm-do-te-kete-buxhet-me-te-vogel-per-2-milion-euro/>

¹⁰ Meta.mk (03.11.2017.) RTM-ja: Ne kemi borxh të madh, mirëpo edhe DHP-ja na ka borxh 34 milionë euro. <http://meta.mk/mrt-nie-dolzime-mnogu-ama-i-ujp-ni-dolzhi-34-milioni-evra/>

¹¹ Qeveria e Republikës së Maqedonisë. (04.07.2017) Plani 3-6-9.

<http://vlada.mk/sites/default/files/programa/2017-2020/Plan%203-6-9%20MKD.pdf>

këtij propozim-ligji duhet të jetë gati më së voni deri më 30 nëntor të vitit 2017.¹² Me të pritët që të zgjidhen gjendjet dhe problemet që janë potencuar nga shumica e organizatave relevante ndërkombëtare, e të cilat kanë të bëjnë me implementimin e rregullativës ligjore, si dhe me funksionimin e organit rregullator dhe të transmetuesit publik të radiodifuzionit.

Ndjekja e raporteve financiare të RTM-së, si dhe [analizat](#)¹³ për punën e saj financiare kundrejt mënyrës së financimit, tregojnë se gjendja në RTM është brengosëse. Edhe përkundër reagimeve¹⁴ për gjendjet e këtilla në transmetuesin publik, asnjëra nga palët e interesuara dhe ato përgjegjëse nuk publikuan ndonjë plan për tejkalimin e gjendjeve.

1.2. Për nevojën për reforma në transmetuesin publik të radiodifuzionit qartë bëjnë me dije edhe raportet e ASHAAM-it nga ndjekja¹⁵ e raportimit mediatik gjatë zgjedhjeve lokale të vitit 2017. Indikative është ajo se ASHAAM-i madje në dy raporte të vëzhgimit konstaton se raportimi i transmetuesit publik të radiodifuzionit nuk ka qenë i balancuar. Në [raportin e tij të katërt dhjetëditor](#)¹⁶ për porgamin e parë të RTM-së, ASHAAM-i konstaton: "...në momente të caktuara ka bërë përzgjedhje jokritike gjatë transmetimit të qëndrimeve të partisë më të madhe opozitare (për shembull katër herë i ka transmetuar reagimet e VMRO-DPMNE-së për temën e njëjtë – kundër Rashkovskit, sekretarit gjeneral të qeverisë). Në atë mënyrë, TVM1 nuk i është përmbajtur përcaktimit nga rregullat e tij për mbulim mediatik të zgjedhjeve lokale, sipas të cilit në lajme deri në fillimin e fushatës zgjedhore do të sigurojë raportim të balancuar për aktivitetet e partive politike të pushtetit dhe atyre të opozitës që janë prezantuar në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë..." Në [raportin e tij të pestë dhjetëditor](#)¹⁷, ASHAAM-i konstaton shkelje të dispozitave të Kodit zgjedhor, gjegjësisht emetim të deklaratave nga bartësi i funksionit publik gjatë heshtjes zgjedhore për rrethin e dytë zgjedhor të zgjedhjeve lokale. Me këtë rast, ASHAAM-i, raporton se kundër "Radios së Maqedonisë" do të parashtrijë padi kundërvajtëse.

¹² Raportimi për fillimin e procesit për përgatitjen e Propozim-ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shërbime audio dhe audiovizuale mediatike. ENER.

https://ener.gov.mk/default.aspx?item=pub_regulation&subitem=view_ann_detail&itemid=KNDpcXvO3NdR8vnXlc7Xxw==

¹³M. Atanasoska-Manasieva. (26.10.2017.) RTM-ja zhytet në borxhe, UER-i fut sanksione dhe ndalesa.

Observatori për reforma mediatike. <http://mediaobservatorium.mk/sq/rtm-ja-zhytet-ne-borxhe-uer-i-fut-sanksione-dhe-ndalesa/>

¹⁴ Meta.mk (31.10.2017.) SHGM: Qeveria urgjentisht ta paguajë borxhin e RTM-së që të mos shkëputemi nga UER-i. <http://meta.mk/znm-vladata-itno-da-go-namiri-dolgot-na-mrt-za-ne-bideme-otsecheni-od-ebu/>

¹⁵ ASHAAM. Raportet dhjetëditore nga monitoringu i raportimit mediatik për zgjedhjet lokale të vitit 2017. <http://avmu.mk/%d0%b4%d0%b5%d1%81%d0%b5%d1%82%d0%b4%d0%bd%d0%b5%d0%b2%d0%bd%d0%b8-%d0%b8%d0%b7%d0%b2%d0%b5%d1%88%d1%82%d0%b0%d0%b8-%d0%be%d0%b4-%d0%bc%d0%be%d0%bd%d0%b8%d1%82%d0%be%d1%80%d0%b8%d0%bd%d0%b3%d0%be/>

¹⁶ ASHAAM. Zgjedhjet lokale 2017: Raport nga monitoringu i mbulimit mediatik për periudhën prej 6 deri më 15 shtator të vitit 2017. <http://avmu.mk/wp-content/uploads/2017/09/lzvestaj-za-period-od-6-do-15-septemvri-2017.pdf>

¹⁷ ASHAAM. Zgjedhjet lokale 2017: Raport nga monitoringu i mbulimit mediatik për periudhën prej 16 deri më 24 shtator të vitit 2017. <http://avmu.mk/wp-content/uploads/2017/09/lzvestaj-od-monitoring-za-lokalni-izbori-2017-za-period-od-16-do-24-septemvri.pdf>

Pjesërisht e
realizuar

2. Reklamimi qeveritar

Sa i përket reklamimit qeveritar, si një nga fushat në të cilën duhet të fokusohet RUP, rekomandimet janë “që të vendosen rregulla të rrepta për reklamimin qeveritar, të bazuara në kritere transparente, objektive dhe jodiskriminuese; të sigurohet transparencë e plotë e reklamimit qeveritar (jo vetëm në aspekt të shpenzimit të parave publike, por edhe në aspekt të pranuesve të tyre dhe përmbajtjeve); të zhvillohet një mekanizëm për shpalljet falas në transmetuesit publik të cilat me të vërtetë janë me interes publik”.

Qeveria njoftoi se i heq reklamimet e saj në media dhe se komunikimi i mëtutjeshëm me publikun do të bëhet nëpërmjet transmetuesit publik dhe mediave sociale. Në ueb-faqen e qeverisë në kuadër të [raportit](#)¹⁸ nga mbledhja e mbajtur e qeverisë, të publikuar më 22 gusht të vitit 2017, thuhet: “Qeveria sot e miratoi masën nga plani “3-6-9”, e cila ka të bëjë me ndërprerjen e reklamave qeveritare në transmetuesit komercialë dhe mediat e shtypura, bilbordet, portalet në internet (me përjashtim të mediave sociale) dhe zhvendosjen e komunikimit me qytetarët nëpërmjet transmetuesit publik të radiodifuzionit. Në përputhje me këtë masë, qeveria e RM-së solli konkluzion me të cilin obligohen të gjitha organet e administratës shtetërore, u bëhet me dije të gjitha institucioneve që nuk kanë status të organeve të administratës shtetërore dhe u rekomandohet njësisive të vetëqeverisjes lokale ta ndërpresin emetimin, gjegjësisht reklamimin e fushatave/spoteve në hapësirë të paguar në transmetuesit elektronikë komercialë, televizionet dhe radiot, mediat e shtypura ditore dhe javore”.

Megjithatë, nga qeveria nuk u dhanë sqarime të detajuara për disa specifika në aspekt të kësaj problematike dhe mbetën të paprecizuara disa çështje:

- 2.1. A do të paguajë qeveria reklama kur do të komunikojë me publikun nëpërmjet transmetuesit publik të radiodifuzionit - RTVM?
- 2.2. A planifikon qeveria, kur informoi se do të komunikojë me publikun nëpërmjet rrjeteve sociale, të paguajë për produksionin e shpalljeve ose klipeve reklamuese, të cilat pastaj do të emetohen si reklama të paguara në “Facebook”, “Twitter” dhe në rrjetet e tjera sociale?
- 2.3. Në çfarë mënyrë qeveria do ta përdorë njësinë e saj për marrëdhënie me publikun dhe të punësuarit në të në funksion të rolit të saj proaktiv gjatë komunikimit me publikun nëpërmjet “Facebook”-ut, “Twitter”-it dhe rrjeteve të tjera sociale?

¹⁸ Qeveria e RM-së. (22.08.2017.) Mbledhja e 24 e Qeverisë së RM-së: Ndërpriten reklamimet qeveritare. <http://vlada.mk/node/13272>

Pjesërisht e
realizuar

3. Qasja te informatat

Në pjesën e qasjes te informatat, në kuadër të RUp kërkohet “të trajtohen pengesat kryesore me të cilat përballen gazetarët gjatë marrjes së informatave publike (p.sh. mosarritja e organeve relevante që të përgjigjen në shumë kërkesa për informata, përdorimi i tepërt pa arsye i termit “sekret” për dokumentet të nuk kanë natyrë të tillë)”.

Masa e parë për përmirësimin e transparencës dhe llogaridhënies së qeverisë ishte vendimi me të cilin sigurohet qasje e hapur nëpërmjet internetit në [mbledhjet e qeverisë](#)¹⁹. Interes të veçantë për të treguan [punëtorët mediatikë](#)²⁰, të cilët nga përbërja paraprake e qeverisë merrnin informata të varfëra për punën e qeverisë. Për përmirësimin e qasjes deri te informatat me karakter publik, [qeveria solli vendim](#)²¹ me të cilin sigurohet qasja falas për gazetarët në dy baza publike të të dhënave: Regjistrin qendror dhe Kadastrën e RM-së. Në procesverbalin e mbledhjes²², ky vendim arsyetohet me nevojën e gazetarëve dhe të punëtorëve mediatikë që t’u sigurohet qasje e lirë deri te burimet e informatave me rëndësi të veçantë për gazetarinë hulumtuese. Edhe pse shoqatat mediatike [përsëriten](#)²³ këtë masë të qeverisë, megjithatë ajo kishte paqartësi, për interpretimin e të cilave nevojiteshin sqarime plotësuese nga shërbimi i qeverisë për marrëdhënie me publikun dhe nga Regjistri qendror dhe Kadastra e RM-së. Në mungesë të procedurës formale me shkrim, [zëdhënësi i qeverisë dhe drejtoresha e Regjistrit qendror sqaruan](#)²⁴ se gazetarët gjatë kërkesës për qasje falas, duhet ta shënojnë temën për të cilën do të shkruajnë dhe duhet të dorëzojnë letër të vulosur nga redaksia në të cilën punojnë. Kjo masë ofron lehtësim të pjesërishtë gjatë qasjes deri te informatat me karakter publik për shkak se vlen për dy institucione, që kanë informata me karakter publik, e poashtu vlen vetëm për një kategori të qytetarëve, gjegjësisht për gazetarët dhe punëtorët mediatikë. Prandaj, konstatohet se edhe palë të tjera të interesuara, të cilat poashtu janë të interesuara të realizojnë aktivitete me interes publik, siç janë ekipet hulumtuese, bashkësia akademike dhe sektori i OJQ-ve, ekologjistët etj., janë të përjashtuar nga kjo qasje.

Sa i përket procedurës, ka disa paqartësi. Sipas sqarimeve, kjo qasje falas i përjashton gazetarët e lirë për shkak se ata nuk kanë redaksi nga e cila do të dorëzonin letër, e cila është e domosdoshme gjatë kërkimit të qasjes falas. Poashtu, nuk është theksuar se kush është personi i autorizuar apo funksioni që ka kompetencë ta refuzojë kërkesën për qasje të lirë deri te informatat në dy institucionet

¹⁹ Qeveria e RM-së. Mbledhjet e qeverisë. <http://vlada.mk/vladini-sednici>

²⁰ Meta.mk. (17.08.2017.) Qeveria i hapi mbledhjet – rendi i ditës dhe procesverbalet gjenden në internet. <http://meta.mk/vladata-gi-otvori-sednitsite-dnevniot-red-i-zapisnitsite-dostapni-na-internet/>

²¹ Qeveria e RM-së. (05.09.2017.) Komunikatë. <http://vlada.mk/node/13343>

²² “Të drejtën e mediave dhe të gazetarëve që në mënyrë të lirë dhe të papenguar të raportojnë dhe të hulumtojnë, qeveria sot e mbështeti edhe me një masë, me të cilën punëtorëve mediatikë u mundësohet e drejta për shfrytëzim falas të shërbimeve të Regjistrit qendror dhe të Agjencisë për kadastrin e patundshmërive. Me këtë masë të saj, Qeveria e Republikës së Maqedonisë i plotësoi kërkesat e gazetarëve dhe të shoqatave të gazetarëve dhe siguroi qasje të lirë deri te burimet e informatave me rëndësi të veçantë për gazetarinë hulumtuese.” – citim nga procesverbali i mbledhjes së qeverisë, i publikuar më 5.9.2017.

²³ Meta.mk. (06.09.2017) SPGPM-ja e përsëriti qasjen falas deri te dokumentet e Kadastrës dhe të Regjistrit qendror. <http://meta.mk/ssnm-go-pozdravi-besplatniot-pristap-do-dokumenti-od-karastarot-i-od-tsentrlniot-registar/>

²⁴ Meta.mk. (13.09.2017) Që të marrin dokumente falas, gazetarët duhet të sqarojnë se pse i kërkojnë. <http://meta.mk/za-besplatni-dokumenti-od-tsentrlnen-registar-novinarite-treba-da-objasnat-zoshto-gi-baraat/>

e lartpërmendura dhe në cilat kushte mund të refuzohet kërkesa e tillë nga ana e institucionit që ka informata me karakter publik.

Në periudhën e raportimit, qeveria nuk paralajmëroi ndryshim dhe plotësim të Ligjit për qasjen e lirë deri te informatat me karakter publik, që në periudhën e kaluar u kërkuar disa herë nga organizata të ndryshme qytetare dhe punëtorë mediatikë.

Fare e
perealizuar

4. Shpifja

Dokumenti për reformat prioritare në aspekt të reformave në fushën e mediave në fushën e katërt – shpifja – parasheh “zvogëlim të numrit të rasteve të shpifjes që arrijnë në gjykata, gjë që duhet të arrihet me: ndryshim të legjislacionit që të largohen rastet e llojit “nderi”, “dinjiteti” dhe “ofendimi”, të cilat iniciohen në përputhje definicionin ligjor të ofendimit, mirëpo të cilat janë jashtë diapazonit të ofendimit në kuptim të nenit 10 të KEDNJ-së; ndryshim të rregullave procedurale për përjashtimin e rasteve të vogla, dhe në vend të kësaj të ketë rritje të zbatimit të ndërmjetësimit gjatë zgjidhjes së tyre; ndryshim dhe promovim të përdorimit më të madh të vetërregullimit si alternativë për shqyrtimin gjyqësor; garantim dhe zbatim, në nivel politik të praktikimit të vetëkufizimit adekuat nga politikanët dhe funksionarët publikë që të mos iniciohet procedurë për shpifje, në përputhje me parimet e GJEDNJ-së”.

Sipas raportit të fundit të Pribes të vitit 2017²⁵, i cili ndërlidhet me raportin e vitit 2015²⁶, është regjistruar zvogëlim i rasteve gjyqësore për shpifje dhe për këtë pjesë të pakos reformuese thuhet se nuk trajtohet si fushë që brengos më së shumti. Megjithatë, sipas hulumtimeve dhe analizave të Shoqatës së gazetarëve të Maqedonisë (SHGM), akoma ekzistojnë rreth tridhjetë raste aktive gjyqësore për shpifje dhe ofendim. Edhe pse ky numër, në krahasim me vitet e mëparshme, paraqet zvogëlim drastik të kësaj dukurie negative, mbetet të zgjidhen edhe disa trende negative. Në fakt, gjykata bën dallim ndërmjet punëtorëve mediatikë që vijnë nga mediat tradicionale dhe atyre që punojnë në mediat në internet. Ky dallim vjen nga ndryshimet në Ligjin për media të vitit 2014²⁷, ku nga neni 2, pika 1 dhe 4 është fshirë fjala “publikime elektronike”. Gjykatësit në arsyetimet e tyre theksojnë se mediat në internet “nuk janë mjete të informimit publik”, dhe me këtë nuk janë të legjitimuar të jenë përgjegjës për shkaktim të dëmit nëpërmjet publikimit në portalet në internet. Mirëpo, gazetarët e mediave në internet që janë të paditur për shpifje dhe ofendim, në vend të parimit ligjor për pagesë të dëmshpërblimit nga media sipas parimit gazetari – redaktori – pronari i medias: 2.000 euro -10.000 euro -15.000 euro, tani marrin kërkesa për dëmshpërblim pa kufizim të shumës.

Poashtu, në këtë fushë duhet të insistohet që të harmonizohen vendimet gjyqësore me praktikën e Gjykatës Evropiane për të drejtat e njeriut në Strasburg.

²⁵ Senior expert group. (14.09.2017.) The former Yugoslav Republic of Macedonia: Assessment and recommendations of the Senior Experts' Group on systemic Rule of Law issues 2017.

https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/2017.09.14_seg_report_on_systemic_rol_issues_for_publication.pdf
fq.24, paragrafi 122

²⁶ Komisioni Evropian, DGJ Politika evropiane për fqinjësi dhe negociatat për zgjerim. Reformat urgjente prioritare për ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë (qershor 2015)
https://eeas.europa.eu/sites/eeas/files/urgent_reform_priorities_mk.pdf

²⁷ MSHIA. Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për media. Publikuar në Gazetën zyrtare numër: 13/2014. http://mioa.gov.mk/files/pdf/dokumenti/zakoni/Zakon_za_izmenuvanje_i_dopolnuvanje_na_zakono_t_za_mediumi_13-2014.pdf

Literatura e shfrytëzuar

- Przino Agreement – Agreement in Skopje to overcome political crisis, 2 June 2015, Skopje.
- Prioritetet për reformat urgjente për Republikën e Maqedonisë, Komisioni Evropian, DGJ Politika evropiane për fqinjësi dhe negociatat për zgjerim, qershor 2015.
- Programi për punë i Qeverisë së RM-së, 2017- 2020.
- Plani “3-6-9” i Qeverisë së RM-së, 2017-2018.
- Recommendations of the Senior Experts' Group on systemic Rule of Law issues relating to the communications interception revealed in spring 2015.
- Assessment and recommendations of the Senior Experts' Group on systemic Rule of Law issues, 2017.